



PROKURORISË SPECIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Departamentit për Korrupsion dhe Krim Financiar

Në mbështetje të nenit 80, paragrafi 1 të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Frashër Krasniqi, në cilësi të përfaqësuesit të Partisë Social Demokrate, me datën 24 prill 2024, e parashtron këtë:

KALLËZIM PENAL

Kundër të dyshuarit të parë:

- **Naser Afizi**, Zëvendësues i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, me adresë ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10000, Prishtinë

sepse

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se përgjatë periudhës kohore brenda viteve 2021-2024, Naser Afizi, në cilësi të personit zyrtar, përkatësisht si Zëvendësues i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke e shfrytëzuar autoritetin e tij zyrtar, në vazhdimësi, i tejkalon kompetencat e tij, me qëllim që të krijojë dobi të kundërligjshme financiare një numri të madh të kompanive prodhuese të ujit ashtu që ka ndërmarre veprime të kundërligjshme administrative duke ai mundësuar një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit t'ia fshijë borxhin e akumuluar për shkak të shfrytëzimit të ujit.

Më këtë kishte për të kryer në vazhdimësi veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar të sanksionuar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

dhe

Kundër të dyshuarit të dytë:

- **Liburn Aliut**, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, me adresë ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10000, Prishtinë.

sepse

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se përgjatë periudhës kohore brenda viteve 2021-2024, i dyshuari i dytë, në cilësi të personit zyrtar, përkatësisht si Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke e shfrytëzuar autoritetin e tij zyrtar, në vazhdimësi, nuk e përmbushë detyrën e tij, me qëllim që të krijojë dobi të kundërligjshme financiare një numri të madh të kompanive prodhuese të ujit ashtu që i njëjti nuk ndërmerr asnjë veprim në kuadër të



përgjegjëse të tija publike për të ndaluar një veprimtari sistematike e të kundërligjshme administrative përmes së cilës i mundësohet një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit të iu fshihet borxhi i akumuluar për shkak të shfrytëzimit të ujit

Më këtë kishte për të kryer në vazhdimësi veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar të sanksionuar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Me datën 17 prill 2024, në mediat elektronike, përkatësisht në portalin informativ AlbanianPost është paraqitur lajmi i titulluar “*Ekskluzive: Hajnia multi-milionëshe e Liburn Aliut dhe Naser Hafiziqi*”. Ky raportim më pastaj është pasuar edhe me një numër tjetër të artikujve lidhur me të njëjtën çështje. Nga i njëjti dhe në saje të dokumenteve që janë bërë publike përmes tij, bëhet fjalë për një sërë vendimesh administrative përmes së cilave një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit i është falur një shumë e madhe të detyrimeve financiare ndaj shtetit.

Nga ajo që është raportuar duket se esenca e kësaj çështje penale konsiston në një veprimtari sistematike përmes së cilës një numri të organizatave të biznesit, të cilat për shkak se prodhojnë ujë, përkatësisht ambalazhojnë ujë, të njëjtat qëndrojnë të detyruara nga legjislacioni përkatës në fuqi, t’i paguajnë shtetit një shumë të caktuar financiare në mënyrën dhe kohën e përcaktuar sipas normave specifike në fuqi, por që të njëjtave përmes kësaj veprimtarie të kundërligjshme i është lejuar pastaj që këto shuma parash ti minusojnë drastikisht meqë ia kanë mundësuar që borxhin e tyre ta përcaktojnë vetë.

Në Kosovë çdo organizatë biznesi që merret me prodhimin e ujit të pijshëm është e obliguar që për këtë veprimtari biznesore të pajiset me një leje ujore nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Kjo leje ujore i mundëson subjekteve përfituese shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga pusët shpuese në përputhje me kushtet që përcaktohen në mënyrë specifike për secilën leje e ku në secilën prej tyre përcaktohet sasia maksimale e ujit të shfrytëzuar (për shembull 1, 2 apo 3 litra për sekondë varësisht). Gjithashtu, të gjithë përfituesit e këtyre lejeve qëndrojnë të detyruar të pajisen me ujëmatës përkatës në shërbim të përlllogaritjes sa më të saktë të shfrytëzimit të lejuar të ujit, e ku e cila përlllogaritje përbën bazën mbi të cilën përcaktohet pagesa që pastaj këta detyrohen t’ia paguajnë shtetit.

Në mungesë të raportimeve në kuadër të këtyre ujëmatësve nga ana e këtyre subjekteve, Ministria detyrohet që pagesën t’ia përcaktojë sipas sasisë maksimale të përcaktuar në lejet përkatëse ujore dhe atë në baza të rregullta vjetore. Detyrimi për ta paguar këtë pagesë derivon nga nenet 86, 88, 90 dhe 91 të Ligjit nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës, përderisa përlllogaritja dhe mënyra e kësaj pagese është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ për Strukturën e Pagesave të Ujit në tri format e tij që kanë qenë në fuqi që nga viti 2006 (nr. 06/2021, nr. 02/2016 dhe 06/2006).

Vepra penale që po tregohet në këtë kallëzim penal, duket të ketë ngjarë, në vazhdimësi, për faktin se ajo kryhej në një vend dhe kishte një objekt, përkatësisht për arsye se vepra kryhej në ministrinë



e lartcekur dhe për objekt kishte vetëm një lloj të borxhit, pra atij që derivonte nga pagesat e papaguara të ujit sipas lejeve ujore të subjekteve të ndryshme dhe atë në një periudhë kohore prej vitit 2021 e deri në vitin 2023. Në këtë periudhë kohore të dyshuarit mundësuan ndërtimin e një praktike krejtësisht të re të vendimmarrjes administrative – e cila vepronte kundërligjshëm në dy drejtime – në njërin anë i relativizonte borxhet e përcaktuara nga vetë Ministria për ti mohuar pastaj në tërësi – e në anën tjetër i mundësonte organizatave të biznesit ti përcaktonin vetë borxhet e tyre duke bërë raportime pas afateve ligjore për shumën e përcaktuar ekskluzivisht sipas vullnetit të tyre.

Së këndejmi, këto shuma të borxheve, nga ajo që është raportuar, vërehen të përcaktuara në dy lloj të dokumenteve: të parat janë vendime/njoftime preliminare të nxjerra nga ministria për subjekte të caktuara ku i përcaktohet shuma e saktë e borxheve; dhe nga një raport i përpiluar me datën 01 mars 2022, me nr. të protokollit 342/2022 nga një grup punues ministror që ka qenë i mandatuar të bëjë përlllogaritjen e detyrimeve financiare në kuadër të pagesave të ujit, në të cilin në një renditje tabelare bëhet përlllogaritjet saktë të detyrimeve të dala sipas dy periudhave kohore (2006-2016 dhe 2016-2021).

Por, këtyre shumave të borxheve u humbet karakteri detyrues përmes shkresave, përkatësisht njoftimeve për vendime preliminare që Ministria fillon t'ia dërgojë këtyre subjekteve, përmes të cilave, kundërligjshëm, ia mundëson të raportojnë sasinë e ujit të shfrytëzuar për periudha shumë vjeçare kur kihet parasysh se këto raportime duhet të bëhet vetëm për periudha një vjeçare dhe atë në mënyrë shumë specifike pra ashtu siç është përcaktuar me udhëzimin e lartshënuar administrativ. Në saje të kësaj mundësie, më pastaj subjekte të shumta, i kanë bërë raportimet e tyre sikur kanë shpenzuar tejet pak sasi të ujit krejtësisht sipas vullnetit të tyre e madje as sipas matjeve të konstatuara të ujëmatësve. Si pasojë, borxhet e tyre arrijnë të reduktohen skajshmërisht. Kjo krijon situatën kur atyre praktikisht iu falen borxhet në përmasa marramendëse financiare.

Një shembull që tregon këtë dukuri është i atij të “Compact Group” sh.p.k., të cilës organizatë të biznesit fillimisht përmes njoftimit për vendim preliminar për detyrim financiar, me nr. të protokollit 1989/22-29, i datës 06 prill 2022, i është përlllogaritur borxhi prej 3,616,812.02 Euro, ndërsa më pastaj me vendimin financiar, me nr. të protokollit 80002/, të datës 30 dhjetor 2022 i është përcaktuar në shumën prej 41,443.60 Euro kësisoj duke i krijuara dobi të kundërligjshme financiare prej 3,575,368.42 Euro për këtë organizatë biznesore. Kjo dobi e kundërligjshme financiare për këto organizata biznesi përbën edhe dëmin financiar që i është shkaktuar buxhetit të shtetit meqë në këtë mënyrë është vepruar në mënyrë sistematike me shumë organizata të tjera biznesi.

Nga ajo që është raportuar, i dyshuari i parë, Nazif Azizi duket të jetë personi që drejtpërdrejtë ka qenë i përfshirë në mundësimin, përkatësisht krijimin e gjithë kësaj veprimtarie vendimmarrëse në këtë ministri, e i cili po ashtu paraqitet si nënshkruar në secilin prej këtyre vendimeve me ekspozim penal, të cilat qartazi nga një vështrim *prima facie* paraqesin tejkalim të kompetencave. Për më tepër i njëjti duket të ketë marrë këtë rol, përkatësisht të ketë qenë i veshur me rol më të madh vendimmarrës në saje edhe të pushtetit të marrë nga vetë i dyshuari i dytë, Liburn Aliu. Ky i fundit ku në këtë situatë që ka ngjarë në ministrinë që e drejton është vështirë e perceptueshme të mos ketë qenë i përfshirë – kjo për faktin se kemi të bëjmë me një situatë jo të zakonshme, para së gjithash për shkak të shumave të mëdha financiare që i detyroheshin subjektet e tjera ministrisë, si



dhe vetë numri i madh i subjekteve – e që të gjitha këto vështirë të mund të mendohet që i njëjti të mos ketë qenë i pranishëm në korrespondencën elektronike që është krijuar për të trajtuar këto çështje – e karshi së cilës situatë, i dyshuari i dytë, Liburn Aliu ka zgjedhur të përmbahet nga kryerja e detyrës së tij zyrtare– e cila qartazi kërkon vendosjen e ligjshmërisë karshi këtyre detyrimeve financiare dhe inkasimin sa më të shpejt të tyre. Arsyeshëm në një situatë të tillë, organi administrativ nuk do merrte përgjegjësinë e faljes së këtyre borxheve, por këtë çështje lehtë do mund ta dërgonte për shqyrtim gjyqësor, ku një gjykatë e vendit do mund të jepte vendimin e saj për këto detyrime. Mirëpo ky nuk është rasti me mënyrën se si është vepruar në këtë çështje, prandaj në bazë të raportimeve mediale, por edhe vetë dokumenteve të bëra publike lehtë krijohet bindja se të dyshuarit mund të jenë të përfshirë në kryerjen e veprës së lartpërkthuar penale, meqë shumë prej të gjitha elementeve të kësaj vepre penale janë plotësuar.

Për fund, e vlerësoj se në këtë çështje penale, për arsyet e përshkruara si më lart, ekziston dyshimi i arsyeshëm i kryerjes në vazhdimësi të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nga dy të dyshuarit veç e veç, andaj, përmes këtij kallëzimi penal, i kërkoj Prokurorisë Speciale të fillojë hetimet dhe ta ndriçojë në tërësi këtë rast në të gjitha dimensionet e tij.

Këtij kallëzimi penal ia bashkëngjis të gjitha dokumentet e bëra publike, së bashku me të gjitha raportimet informative mbi këtë çështje

Frashër Krasniqi
Partia Social Demokrate

Më 24 prill 2024,
Prishtinë, Kosovë



PROKURORISË SPECIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Departamentit për Korrupsion dhe Krim Financiar

Në mbështetje të nenit 80, paragrafi 1 të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Frashër Krasniqi, në cilësi të përfaqësuesit të Partisë Social Demokrate, me datën 24 prill 2024, e parashtron këtë:

KALLËZIM PENAL

Kundër të dyshuarit të parë:

- **Naser Afizi**, Zëvendësues i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, me adresë ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10000, Prishtinë

sepse

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se përgjatë periudhës kohore brenda viteve 2021-2024, Naser Afizi, në cilësi të personit zyrtar, përkatësisht si Zëvendësues i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke e shfrytëzuar autoritetin e tij zyrtar, në vazhdimësi, i tejkalon kompetencat e tij, me qëllim që të krijojë dobi të kundërligjshme financiare një numri të madh të kompanive prodhuese të ujit ashtu që ka ndërmarre veprime të kundërligjshme administrative duke ai mundësuar një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit t'ia fshijë borxhin e akumuluar për shkak të shfrytëzimit të ujit.

Më këtë kishte për të kryer në vazhdimësi veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar të sanksionuar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

dhe

Kundër të dyshuarit të dytë:

- **Liburn Aliut**, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, me adresë ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10000, Prishtinë.

sepse

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se përgjatë periudhës kohore brenda viteve 2021-2024, i dyshuari i dytë, në cilësi të personit zyrtar, përkatësisht si Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke e shfrytëzuar autoritetin e tij zyrtar, në vazhdimësi, nuk e përmbushë detyrën e tij, me qëllim që të krijojë dobi të kundërligjshme financiare një numri të madh të kompanive prodhuese të ujit ashtu që i njëjti nuk ndërmerr asnjë veprim në kuadër të



përgjegjëse të tija publike për të ndaluar një veprimtari sistematike e të kundërligjshme administrative përmes së cilës i mundësohet një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit të iu fshihet borxhi i akumuluar për shkak të shfrytëzimit të ujit

Më këtë kishte për të kryer në vazhdimësi veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar të sanksionuar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Me datën 17 prill 2024, në mediat elektronike, përkatësisht në portalin informativ AlbanianPost është paraqitur lajmi i titulluar “*Ekskluzive: Hajnia multi-milionëshe e Liburn Aliut dhe Naser Hafiziqi*”. Ky raportim më pastaj është pasuar edhe me një numër tjetër të artikujve lidhur me të njëjtën çështje. Nga i njëjti dhe në saje të dokumenteve që janë bërë publike përmes tij, bëhet fjalë për një sërë vendimesh administrative përmes së cilave një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit i është falur një shumë e madhe të detyrimeve financiare ndaj shtetit.

Nga ajo që është raportuar duket se esenca e kësaj çështje penale konsiston në një veprimtari sistematike përmes së cilës një numri të organizatave të biznesit, të cilat për shkak se prodhojnë ujë, përkatësisht ambalazhojnë ujë, të njëjtat qëndrojnë të detyruara nga legjislacioni përkatës në fuqi, t’i paguajnë shtetit një shumë të caktuar financiare në mënyrën dhe kohën e përcaktuar sipas normave specifike në fuqi, por që të njëjtave përmes kësaj veprimtarie të kundërligjshme i është lejuar pastaj që këto shuma parash ti minusojnë drastikisht meqë ia kanë mundësuar që borxhin e tyre ta përcaktojnë vetë.

Në Kosovë çdo organizatë biznesi që merret me prodhimin e ujit të pijshëm është e obliguar që për këtë veprimtari biznesore të pajiset me një leje ujore nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Kjo leje ujore i mundëson subjekteve përfituese shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga pusët shpuese në përputhje me kushtet që përcaktohen në mënyrë specifike për secilën leje e ku në secilën prej tyre përcaktohet sasia maksimale e ujit të shfrytëzuar (për shembull 1, 2 apo 3 litra për sekondë varësisht). Gjithashtu, të gjithë përfituesit e këtyre lejeve qëndrojnë të detyruar të pajisen me ujëmatës përkatës në shërbim të përlllogaritjes sa më të saktë të shfrytëzimit të lejuar të ujit, e ku e cila përlllogaritje përbën bazën mbi të cilën përcaktohet pagesa që pastaj këta detyrohen t’ia paguajnë shtetit.

Në mungesë të raportimeve në kuadër të këtyre ujëmatësve nga ana e këtyre subjekteve, Ministria detyrohet që pagesën t’ia përcaktojë sipas sasisë maksimale të përcaktuar në lejet përkatëse ujore dhe atë në baza të rregullta vjetore. Detyrimi për ta paguar këtë pagesë derivon nga nenet 86, 88, 90 dhe 91 të Ligjit nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës, përderisa përlllogaritja dhe mënyra e kësaj pagese është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ për Strukturën e Pagesave të Ujit në tri format e tij që kanë qenë në fuqi që nga viti 2006 (nr. 06/2021, nr. 02/2016 dhe 06/2006).

Vepra penale që po tregohet në këtë kallëzim penal, duket të ketë ngjarë, në vazhdimësi, për faktin se ajo kryhej në një vend dhe kishte një objekt, përkatësisht për arsye se vepra kryhej në ministrinë



e lartcekur dhe për objekt kishte vetëm një lloj të borxhit, pra atij që derivonte nga pagesat e papaguara të ujit sipas lejeve ujore të subjekteve të ndryshme dhe atë në një periudhë kohore prej vitit 2021 e deri në vitin 2023. Në këtë periudhë kohore të dyshuarit mundësuan ndërtimin e një praktike krejtësisht të re të vendimmarrjes administrative – e cila vepronte kundërligjshëm në dy drejtime – në njërin anë i relativizonte borxhet e përcaktuara nga vetë Ministria për ti mohuar pastaj në tërësi – e në anën tjetër i mundësonte organizatave të biznesit ti përcaktonin vetë borxhet e tyre duke bërë raportime pas afateve ligjore për shumën e përcaktuar ekskluzivisht sipas vullnetit të tyre.

Së këndejmi, këto shuma të borxheve, nga ajo që është raportuar, vërehen të përcaktuara në dy lloj të dokumenteve: të parat janë vendime/njoftime preliminare të nxjerra nga ministria për subjekte të caktuara ku i përcaktohet shuma e saktë e borxheve; dhe nga një raport i përpiluar me datën 01 mars 2022, me nr. të protokollit 342/2022 nga një grup punues ministror që ka qenë i mandatar të bëjë përlllogaritjen e detyrimeve financiare në kuadër të pagesave të ujit, në të cilin në një renditje tabelare bëhet përlllogaritjet saktë të detyrimeve të dala sipas dy periudhave kohore (2006-2016 dhe 2016-2021).

Por, këtyre shumave të borxheve u humbet karakteri detyrues përmes shkresave, përkatësisht njoftimeve për vendime preliminare që Ministria fillon t'ia dërgojë këtyre subjekteve, përmes të cilave, kundërligjshëm, ia mundëson të raportojnë sasinë e ujit të shfrytëzuar për periudha shumë vjeçare kur kihet parasysh se këto raportime duhet të bëhet vetëm për periudha një vjeçare dhe atë në mënyrë shumë specifike pra ashtu siç është përcaktuar me udhëzimin e lartshënuar administrativ. Në saje të kësaj mundësie, më pastaj subjekte të shumta, i kanë bërë raportimet e tyre sikur kanë shpenzuar tejet pak sasi të ujit krejtësisht sipas vullnetit të tyre e madje as sipas matjeve të konstatuara të ujëmatësve. Si pasojë, borxhet e tyre arrijnë të reduktohen skajshmërisht. Kjo krijon situatën kur atyre praktikisht iu falen borxhet në përmasa marramendëse financiare.

Një shembull që tregon këtë dukuri është i atij të “Compact Group” sh.p.k., të cilës organizatë të biznesit fillimisht përmes njoftimit për vendim preliminar për detyrim financiar, me nr. të protokollit 1989/22-29, i datës 06 prill 2022, i është përlllogaritur borxhi prej 3,616,812.02 Euro, ndërsa më pastaj me vendimin financiar, me nr. të protokollit 80002/, të datës 30 dhjetor 2022 i është përcaktuar në shumën prej 41,443.60 Euro kësisoj duke i krijuara dobi të kundërligjshme financiare prej 3,575,368.42 Euro për këtë organizatë biznesore. Kjo dobi e kundërligjshme financiare për këto organizata biznesi përbën edhe dëmin financiar që i është shkaktuar buxhetit të shtetit meqë në këtë mënyrë është vepruar në mënyrë sistematike me shumë organizata të tjera biznesi.

Nga ajo që është raportuar, i dyshuari i parë, Nazif Azizi duket të jetë personi që drejtpërdrejtë ka qenë i përfshirë në mundësimin, përkatësisht krijimin e gjithë kësaj veprimtarie vendimmarrëse në këtë ministri, e i cili po ashtu paraqitet si nënshkruar në secilin prej këtyre vendimeve me ekspozim penal, të cilat qartazi nga një vështrim *prima facie* paraqesin tejkalim të kompetencave. Për më tepër i njëjti duket të ketë marrë këtë rol, përkatësisht të ketë qenë i veshur me rol më të madh vendimmarrës në saje edhe të pushtetit të marrë nga vetë i dyshuari i dytë, Liburn Aliu. Ky i fundit ku në këtë situatë që ka ngjarë në ministrinë që e drejton është vështirë e perceptueshme të mos ketë qenë i përfshirë – kjo për faktin se kemi të bëjmë me një situatë jo të zakonshme, para së gjithash për shkak të shumave të mëdha financiare që i detyroheshin subjektet e tjera ministrisë, si



dhe vetë numri i madh i subjekteve – e që të gjitha këto vështirë të mund të mendohet që i njëjti të mos ketë qenë i pranishëm në korrespondencën elektronike që është krijuar për të trajtuar këto çështje – e karshi së cilës situatë, i dyshuari i dytë, Liburn Aliu ka zgjedhur të përmbahet nga kryerja e detyrës së tij zyrtare– e cila qartazi kërkon vendosjen e ligjshmërisë karshi këtyre detyrimeve financiare dhe inkasimin sa më të shpejt të tyre. Arsyeshëm në një situatë të tillë, organi administrativ nuk do merrte përgjegjësinë e faljes së këtyre borxheve, por këtë çështje lehtë do mund ta dërgonte për shqyrtim gjyqësor, ku një gjykatë e vendit do mund të jepte vendimin e saj për këto detyrime. Mirëpo ky nuk është rasti me mënyrën se si është vepruar në këtë çështje, prandaj në bazë të raportimeve mediale, por edhe vetë dokumenteve të bëra publike lehtë krijohet bindja se të dyshuarit mund të jenë të përfshirë në kryerjen e veprës së lartpërkthuar penale, meqë shumë prej të gjitha elementeve të kësaj veprë penale janë plotësuar.

Për fund, e vlerësoj se në këtë çështje penale, për arsyet e përshkruara si më lart, ekziston dyshimi i arsyeshëm i kryerjes në vazhdimësi të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nga dy të dyshuarit veç e veç, andaj, përmes këtij kallëzimi penal, i kërkoj Prokurorisë Speciale të fillojë hetimet dhe ta ndriçojë në tërësi këtë rast në të gjitha dimensionet e tij.

Këtij kallëzimi penal ia bashkëngjis të gjitha dokumentet e bëra publike, së bashku me të gjitha raportimet informative mbi këtë çështje

Frashër Krasniqi
Partia Social Demokrate

Më 24 prill 2024,
Prishtinë, Kosovë



PROKURORISË SPECIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Departamentit për Korrupsion dhe Krim Financiar

Në mbështetje të nenit 80, paragrafi 1 të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Frashër Krasniqi, në cilësi të përfaqësuesit të Partisë Social Demokrate, me datën 24 prill 2024, e parashtron këtë:

KALLËZIM PENAL

Kundër të dyshuarit të parë:

- **Naser Afizi**, Zëvendësues i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, me adresë ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10000, Prishtinë

sepse

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se përgjatë periudhës kohore brenda viteve 2021-2024, Naser Afizi, në cilësi të personit zyrtar, përkatësisht si Zëvendësues i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke e shfrytëzuar autoritetin e tij zyrtar, në vazhdimësi, i tejkalon kompetencat e tij, me qëllim që të krijojë dobi të kundërligjshme financiare një numri të madh të kompanive prodhuese të ujit ashtu që ka ndërmarre veprime të kundërligjshme administrative duke ai mundësuar një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit t'ia fshijë borxhin e akumuluar për shkak të shfrytëzimit të ujit.

Më këtë kishte për të kryer në vazhdimësi veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar të sanksionuar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

dhe

Kundër të dyshuarit të dytë:

- **Liburn Aliut**, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Republikës së Kosovës, me adresë ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10000, Prishtinë.

sepse

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se përgjatë periudhës kohore brenda viteve 2021-2024, i dyshuari i dytë, në cilësi të personit zyrtar, përkatësisht si Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke e shfrytëzuar autoritetin e tij zyrtar, në vazhdimësi, nuk e përmbushë detyrën e tij, me qëllim që të krijojë dobi të kundërligjshme financiare një numri të madh të kompanive prodhuese të ujit ashtu që i njëjti nuk ndërmerr asnjë veprim në kuadër të



përgjegjësi të tija publike për të ndaluar një veprimtari sistematike e të kundërligjshme administrative përmes së cilës i mundësohet një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit të iu fshihet borxhi i akumuluar për shkak të shfrytëzimit të ujit

Më këtë kishte për të kryer në vazhdimësi veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar të sanksionuar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Me datën 17 prill 2024, në mediat elektronike, përkatësisht në portalin informativ AlbanianPost është paraqitur lajmi i titulluar “*Ekskluzive: Hajnia multi-milionëshe e Liburn Aliut dhe Naser Hafiziqi*”. Ky raportim më pastaj është pasuar edhe me një numër tjetër të artikujve lidhur me të njëjtën çështje. Nga i njëjti dhe në saje të dokumenteve që janë bërë publike përmes tij, bëhet fjalë për një sërë vendimesh administrative përmes së cilave një numri të pacaktuar të organizatave të biznesit i është falur një shumë e madhe të detyrimeve financiare ndaj shtetit.

Nga ajo që është raportuar duket se esenca e kësaj çështje penale konsiston në një veprimtari sistematike përmes së cilës një numri të organizatave të biznesit, të cilat për shkak se prodhojnë ujë, përkatësisht ambalazhojnë ujë, të njëjtat qëndrojnë të detyruara nga legjislacioni përkatës në fuqi, t’i paguajnë shtetit një shumë të caktuar financiare në mënyrën dhe kohën e përcaktuar sipas normave specifike në fuqi, por që të njëjtave përmes kësaj veprimtarie të kundërligjshme i është lejuar pastaj që këto shuma parash ti minusojnë drastikisht meqë ia kanë mundësuar që borxhin e tyre ta përcaktojnë vetë.

Në Kosovë çdo organizatë biznesi që merret me prodhimin e ujit të pijshëm është e obliguar që për këtë veprimtari biznesore të pajiset me një leje ujore nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Kjo leje ujore i mundëson subjekteve përfituese shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga pusët shpuese në përputhje me kushtet që përcaktohen në mënyrë specifike për secilën leje e ku në secilën prej tyre përcaktohet sasia maksimale e ujit të shfrytëzuar (për shembull 1, 2 apo 3 litra për sekondë varësisht). Gjithashtu, të gjithë përfituesit e këtyre lejeve qëndrojnë të detyruar të pajisen me ujëmatës përkatës në shërbim të përlllogaritjes sa më të saktë të shfrytëzimit të lejuar të ujit, e ku e cila përlllogaritje përbën bazën mbi të cilën përcaktohet pagesa që pastaj këta detyrohen t’ia paguajnë shtetit.

Në mungesë të raportimeve në kuadër të këtyre ujëmatësve nga ana e këtyre subjekteve, Ministria detyrohet që pagesën t’ia përcaktojë sipas sasisë maksimale të përcaktuar në lejet përkatëse ujore dhe atë në baza të rregullta vjetore. Detyrimi për ta paguar këtë pagesë derivon nga nenet 86, 88, 90 dhe 91 të Ligjit nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës, përderisa përlllogaritja dhe mënyra e kësaj pagese është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ për Strukturën e Pagesave të Ujit në tri format e tij që kanë qenë në fuqi që nga viti 2006 (nr. 06/2021, nr. 02/2016 dhe 06/2006).

Vepra penale që po tregohet në këtë kallëzim penal, duket të ketë ngjarë, në vazhdimësi, për faktin se ajo kryhej në një vend dhe kishte një objekt, përkatësisht për arsye se vepra kryhej në ministrinë



e lartcekur dhe për objekt kishte vetëm një lloj të borxhit, pra atij që derivonte nga pagesat e papaguara të ujit sipas lejeve ujore të subjekteve të ndryshme dhe atë në një periudhë kohore prej vitit 2021 e deri në vitin 2023. Në këtë periudhë kohore të dyshuarit mundësuan ndërtimin e një praktike krejtësisht të re të vendimmarrjes administrative – e cila vepronte kundërligjshëm në dy drejtime – në njërin anë i relativizonte borxhet e përcaktuara nga vetë Ministria për ti mohuar pastaj në tërësi – e në anën tjetër i mundësonte organizatave të biznesit ti përcaktonin vetë borxhet e tyre duke bërë raportime pas afateve ligjore për shumën e përcaktuar ekskluzivisht sipas vullnetit të tyre.

Së këndejmi, këto shuma të borxheve, nga ajo që është raportuar, vërehen të përcaktuara në dy lloj të dokumenteve: të parat janë vendime/njoftime preliminare të nxjerra nga ministria për subjekte të caktuara ku i përcaktohet shuma e saktë e borxheve; dhe nga një raport i përpiluar me datën 01 mars 2022, me nr. të protokollit 342/2022 nga një grup punues ministror që ka qenë i mandatuar të bëjë përlllogaritjen e detyrimeve financiare në kuadër të pagesave të ujit, në të cilin në një renditje tabelare bëhet përlllogaritjet saktë të detyrimeve të dala sipas dy periudhave kohore (2006-2016 dhe 2016-2021).

Por, këtyre shumave të borxheve u humbet karakteri detyrues përmes shkresave, përkatësisht njoftimeve për vendime preliminare që Ministria fillon t'ia dërgojë këtyre subjekteve, përmes të cilave, kundërligjshëm, ia mundëson të raportojnë sasinë e ujit të shfrytëzuar për periudha shumë vjeçare kur kihet parasysh se këto raportime duhet të bëhet vetëm për periudha një vjeçare dhe atë në mënyrë shumë specifike pra ashtu siç është përcaktuar me udhëzimin e lartshënuar administrativ. Në saje të kësaj mundësie, më pastaj subjekte të shumta, i kanë bërë raportimet e tyre sikur kanë shpenzuar tejet pak sasi të ujit krejtësisht sipas vullnetit të tyre e madje as sipas matjeve të konstatuara të ujëmatësve. Si pasojë, borxhet e tyre arrijnë të reduktohen skajshmërisht. Kjo krijon situatën kur atyre praktikisht iu falen borxhet në përmasa marramendëse financiare.

Një shembull që tregon këtë dukuri është i atij të “Compact Group” sh.p.k., të cilës organizatë të biznesit fillimisht përmes njoftimit për vendim preliminar për detyrim financiar, me nr. të protokollit 1989/22-29, i datës 06 prill 2022, i është përlllogaritur borxhi prej 3,616,812.02 Euro, ndërsa më pastaj me vendimin financiar, me nr. të protokollit 80002/, të datës 30 dhjetor 2022 i është përcaktuar në shumën prej 41,443.60 Euro kësisoj duke i krijuara dobi të kundërligjshme financiare prej 3,575,368.42 Euro për këtë organizatë biznesore. Kjo dobi e kundërligjshme financiare për këto organizata biznesi përbën edhe dëmin financiar që i është shkaktuar buxhetit të shtetit meqë në këtë mënyrë është vepruar në mënyrë sistematike me shumë organizata të tjera biznesi.

Nga ajo që është raportuar, i dyshuari i parë, Nazif Azizi duket të jetë personi që drejtpërdrejtë ka qenë i përfshirë në mundësimin, përkatësisht krijimin e gjithë kësaj veprimtarie vendimmarrëse në këtë ministri, e i cili po ashtu paraqitet si nënshkruar në secilin prej këtyre vendimeve me ekspozim penal, të cilat qartazi nga një vështrim *prima facie* paraqesin tejkallim të kompetencave. Për më tepër i njëjti duket të ketë marrë këtë rol, përkatësisht të ketë qenë i veshur me rol më të madh vendimmarrës në saje edhe të pushtetit të marrë nga vetë i dyshuari i dytë, Liburn Aliu. Ky i fundit ku në këtë situatë që ka ngjarë në ministrinë që e drejton është vështirë e perceptueshme të mos ketë qenë i përfshirë – kjo për faktin se kemi të bëjmë me një situatë jo të zakonshme, para së gjithash për shkak të shumave të mëdha financiare që i detyroheshin subjektet e tjera ministrisë, si



dhe vetë numri i madh i subjekteve – e që të gjitha këto vështirë të mund të mendohet që i njëjti të mos ketë qenë i pranishëm në korrespondencën elektronike që është krijuar për të trajtuar këto çështje – e karshi së cilës situatë, i dyshuari i dytë, Liburn Aliu ka zgjedhur të përmbahet nga kryerja e detyrës së tij zyrtare– e cila qartazi kërkon vendosjen e ligjshmërisë karshi këtyre detyrimeve financiare dhe inkasimin sa më të shpejt të tyre. Arsyeshëm në një situatë të tillë, organi administrativ nuk do merrte përgjegjësinë e faljes së këtyre borxheve, por këtë çështje lehtë do mund ta dërgonte për shqyrtim gjyqësor, ku një gjykatë e vendit do mund të jepte vendimin e saj për këto detyrime. Mirëpo ky nuk është rasti me mënyrën se si është vepruar në këtë çështje, prandaj në bazë të raportimeve mediale, por edhe vetë dokumenteve të bëra publike lehtë krijohet bindja se të dyshuarit mund të jenë të përfshirë në kryerjen e veprës së lartpërkthuar penale, meqë shumë prej të gjitha elementeve të kësaj veprë penale janë plotësuar.

Për fund, e vlerësoj se në këtë çështje penale, për arsyet e përshkruara si më lart, ekziston dyshimi i arsyeshëm i kryerjes në vazhdimësi të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 414, paragrafi 2 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nga dy të dyshuarit veç e veç, andaj, përmes këtij kallëzimi penal, i kërkoj Prokurorisë Speciale të fillojë hetimet dhe ta ndriçojë në tërësi këtë rast në të gjitha dimensionet e tij.

Këtij kallëzimi penal ia bashkëngjis të gjitha dokumentet e bëra publike, së bashku me të gjitha raportimet informative mbi këtë çështje

Frashër Krasniqi
Partia Social Demokrate

Më 24 prill 2024,
Prishtinë, Kosovë